

Forumi përmbyllës për promovimin e mirëkuptimit dhe tolerancës fetare në Shqipëri



U zhvillua sot në Tiranë në ambientet e Europe House në Tiranë - Forumi përmbyllës për promovimin e mirëkuptimit dhe tolerancës fetare në Shqipëri mbledhi së bashku shumë të rinj, institucione dhe përfaqësues të klerit me qëllim promovimin e këtyre vlerave të shoqërisë shqiptare!

Në këtë Forum morën pjesë përfaqësues të Komuniteteve fetare në vend, Zv. Ministria e Arsimit Loreta Haxhiu, Ambasadorja e Hollandës znj. Guusje Korthals Altes, përfaqësues nga Komuniteti Shqiptar i Helsinkit, të rinj nga gjimnazet e Tiranës si edhe studentë të Fakulteteve të ndryshme.

Me mjaft interes u ndoqën nga të pranishmit mesazhet që u përcollën nga përfaqësuesit e komuniteteve fetare që kishin të bënin me rëndësinë e ruajtjes dhe kultivimit të harmonisë fetare që ekziston në vend.

Gjithashtu përfaqësuesit e Komuniteteve Fetare të vendit i'u përgjigjën pyetjeve të



[Radio "Ngjallja"/facebook](#)